



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE


VENDIM

Nr.65, dt. 11.04.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.04.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Hec Kalivar 1,2,3,4”, Pukë, Shkodër, me subjekt aplikues “BE-IS” Energy sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture:
Ujësjiellësit të Dom Gjonit sipas projekt-preventivit që do të hartohet nga specialistët DRKK Shkodër.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR
ARTA DOLLANI